

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, në lëndën penale ndaj të pandehurës B.R..., nga Gj..., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilën me autorizim e mbron avokati Taulant Ismajli nga Prishtina, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2253/2023, e datës 13.09.2012, të cilën e përfaqësonte prokurorja Sllavica Popoviq, pas mbajtjes së shqyrtimit filletar dhe publik, më datën 23.08.2023, mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

E pandehura B.R... nga i ati M... dhe e ëma Z..., e lindur P..., e lindur me datën ... në Gj..., ku edhe jeton rruga "...", pn. me numër personal ..., e martuar, ka të kryer shkollën e mesme, menaxhere në „...”, Komuna e Gjilanit, me gjendje të mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës me nr. tel. 043-....

ËSHTË FAJTORE

Sepse me datë 13.11.2022, rreth orës 05:00 minuta, në fshatin Livoq i Epërm, K. Gjilan, e pandehura, nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që: duke drejtuar automjetin e markës „Mini Cooper”, me tabela 06-557-FM, ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 53.1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, në atë mënyrë që, derisa ishte duke lëvizur në rrugën Prishtinë-Gjilan, me të arritur në fshatin Livoq i Epërm, te penda, kthesë në të djathtë, duke mos e përshtatur shpejtësinë e automjetit të saj, kushteve të rrugës e ka humbur kontrollin mbi drejtimin e automjetit dhe kalon jashtë rrugës, në anën e djathtë, të drejtimin të lëvizjes, ku fillimisht godet rrethojën e varrezave, nga gypi dhe teli i metaltë dhe pas disa rrokullisjeve përfundon në pendën e Livoqit të Epërm, me ç’rast shkakton vet aksident, me lëndime trupore, ku lëndime të rënda trupore pëson i dëmtuari - bashkëshorti Shqiprim Ramushi, i cili ka kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan-Emergjencë dhe më pas ka kryer intervenime kirurgjike në repartin e ortopedisë, në Gjilan;

- Me çka ka kryer veprën penale, Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 69, 70, 73, 74 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), e akuzuara B.R...,

LIROHET NGA DENIMI

I. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

II. Obligohet e akuzuara të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

III. Obligohet e akuzuara të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurës B.R..., nga Gjilani, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 23.08.2023, prokurorja Sllavica Popoviq, ka mbetur në tërësi pranë propozim akuzës së lartcekur të paraqitur me shkrim, duke i propozuar gjykatës të pandehurën ta shpall fajtoare,

I dëmtuari Sh.R...deklaroi se nuk i bashkangjitem ndjekjes penale ndaj të pandehurës por paraqes kërkesë pasurore juridike ndaj kompanisë së sigurimeve.

Mbrojtësi i të pandehurës av. Taulant Ismajli gjatë fjalës përfundimtare deklaroi su u vërtetua se e pandehura e ka kryer veprën penale për të cilën edhe e pranoi fajsinë, dhe konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore që e pandehura të lirohet nga dënimi.

E pandehura B.R..., gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se e përkrahi në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës, e pandehura B.R... ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të palëve, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase e pandehura kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve me mbrojtësin e saj; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se e pandehura B.R..., nga pakujdesia ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK, lidhur me nenin 53.1 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, Gjykata e shpalli fajtoare të pandehurën B.R..., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtës i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjëse penalisht.

Duke u bazuar në nenin 73 paragrafi 1 të KPRK-s, gjykata e liroi nga dënimi të pandehurën, pasi që e pandehura të dëmtuarin Shqiprim Ramushin e ka bashkshort, çka do të thotë se e pandehura

të dëmtuarin ka anëtarë të familjes së ngushtë, rasti e ka goditur aq shumë sa që çfarëdo dënimi ti shqiptohet ndaj të pandehurës nuk do të arrin efektin-qëllimin e dënimit se në këtë rast e njëjta i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore bashkshortit të saj.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPPK, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 paragrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

Më 23.08.2023

**Sekretarja juridike,
Fatmire Sermaxhaj**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Behar Ymeri**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas vlerësimit të mbrojtjes të pandehurit në fjalë dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës mori dhe në prani të Prokurorit të shtetit, të dëmtuarit dhe të pandehurës, me mbrojtësin e saj në të njëjtën ditë publikisht shpalli,

NË EMËR TË POPULLIT A K T G J Y K I M

E pandehura B.R... nga i ati Milaim dhe e ëma Zejnie, e lindur Pacolli, e lindur me datën 19.11.1999 në Gjilan, ku edhe jeton rruga “Avdullah Tahiri”, pn. me numër personal 1241946467, e martuar, ka të kryer shkollën e mesme, menaxhere në „Gerti Group”, Komuna e Gjilanit, me gjendje të mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës me nr. tel. 043-536-884.

ËSHTË FAJTORE

Sepse me datë 13.11.2022, rreth orës 05:00 minuta, në fshatin Livoq i Epërm, K. Gjilan, e pandehura, nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që: duke drejtuar automjetin e markës „Mini Cooper”, me tabela 06-557-FM, ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 53.1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, në atë mënyrë që, derisa ishte duke lëvizur në rrugën Prishtinë-Gjilan, me të arritur në fshatin Livoq i Epërm, te penda, kthesë në të djathtë, duke mos e përshtatur shpejtësinë e automjetit të saj, kushteve të rrugës e ka humbur kontrollin mbi drejtimin e automjetit dhe kalon jashtë rrugës, në anën e djathtë, të drejtimit të lëvizjes, ku fillimisht godet rrethojën e varrezave, nga gypi dhe teli i metaltë dhe pas disa rrokullisjeve përfundon në pendën e Livoqit të Epërm, me ç’rast shkakton vet aksident, me lëndime trupore, ku lëndime të rënda trupore pëson i dëmtuari - bashkëshorti Shqiprim Ramushi, i cili ka kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan-Emergjencë dhe më pas ka kryer intervenime kirurgjike në repartin e ortopedisë, në Gjilan;

- Me çka ka kryer veprën penale, Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 69, 70, 73, 74 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), e akuzuara B.R...,

LIROHET NGA DENIMI

I. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

II. Obligohet e akuzuara të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të kriminit në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

III. Obligohet e akuzuara të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Përfundoi në ora 09,40 minuta.

V e r t e t o j n ë

Sek. juridike,

G j y k a t ë s i